

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**3IS Holding**

NENI 1  
FORMIMI

**Sot me date 01.05.2024** themeluesit qe firmosin me poshte:

1. **Z. Islam Isufaj**, i datëlindjes 22.01.1958, lindur në Fier, banues në Tirane, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.Personal: F80122105H.
2. **Z. Evis Isufaj**, i datëlindjes 22.10.1992, lindur në Fier, banues në Tirane, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.Personal: J21022063F.
3. **Shoqeria “A I”** e regjistruar me nr **NIPT M32414009M**, e perfaqesuar nga administratori i shoqerise Z. Arben Isufaj, i datelindjes 16,04,1987, lindur dhe banues ne Fier, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me Nr I70416086E

Ne baze te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 „Per Tregtetaret dhe Shoqerite Tregtare „, si dhe Ligji 9723 dt 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit “ themeloj me vullnet te lire shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar ,me emertim **3IS Holding**.

NENI 2  
SELIA

Selia e shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar **3IS Holding**, me adrese: Rruga “Teodor Keko”, ZK. 866, Pll.1, Shk. 3, Kati 5, Yzberisht, Tirane. Shoqeria ka te drejte te hape filiale ne te gjithë vendin.

NENI 3  
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **3IS Holding** eshte pa afat nga momenti i regjistrimit te saj prane QKB Tirane.

NENI 4  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise **3IS Holding** eshte:  
Shoqeria ka per objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, duke u fokusuar kryesisht ne: Investimi ne instrument financiar (te cilet perfshijne pa kufizime titujt e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat ne fonde investimesh etj), investimi ne pasuri te paluajtshme dhe ne asetë (te preکشme apo te paprekshme), si dhe ofrimi I shërbimeve te konsulences per shoqerite e kontrolluara prej saj dhe/ose te trete (te cilet perfshijne pa kufizime konsulencen e natyres

financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwares etj.) ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj. Gjithashtu, shoqeria mund te kryej cdo veprim, operacion apo transakcion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundërshtim dhe mos alterojne objektin paresor te veprimtarise se shoqerise. Shoqeria mund të blejë dhe të shesë lirisht pjesë të kapitalit të shoqërive në pronësi në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi. Per permbushjen e objektit te saj Shoqeria mund te marre pjese dhe te jete e interesuar ne shoqeri dhe siper marrje, shqiptare apo te huaja, qe kryejne aktivite te njehta, te ngjashme apo te lidhura me aktivitetin e saj ose te subjekteve pjesemarrase; Shoqeria mund te veproje ne Shqiperi dhe jashte saj dhe te kryejte cdo aktivitet tjeter te lidhur, ndihmes me qellim te permbushje ose te jete i dobishem per permbushjen e objektit ta saj. Shoqeria mund te kryejte edhe aktivite te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

## NENI 5 KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqërisë **3IS Holding** është **100,000 leke** dhe i ndare ne 3 kuota me kontributin e ortakeve si me poshtë:

1. Një kuote **Z. Islam Isufaj** ne masën 34 % (Tridhjetë e kater perqind) te kapitalit themeltar.
2. Një kuote **Z. Evis Isufaj** ne masën 33 % (tridhjetë e tre perqind) te kapitalit themeltar.
3. Një kuote Shoqeria “**A I**” e rregjistruar me nr **NIPT M32414009M**, e perfaqesuar nga administratori i shoqerise **Z. Arben Isufaj**, i datelindjes 16,04,1987, lindur Fier dhe banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me Nr I70416086E, i cili zoteron nje kuote ne masën 33 % (tridhjetë e tre perqind) te kapitalit themeltar.

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga themeluesit, ata mund të ndryshojnë sipas vendimit që mund të marrin ortakët , por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

## NENI 6 ORGANET E SHOQERISE DHE ASAMBLEJA

Organet drejtuese te shoqërisë **3IS Holding** janë:

- Asambleja e Ortakeve ,organi me i larte vendim marres
- Administrator te shoqerise do te jete :  
**Z. Arben Isufaj** mbajtes i kartes se identitetit me Nr I70416086E. Kohëzgjatja e administratorit është 5 vjet, **nga data 01.05.2024 deri ne 01.05.2029**

Administratoret veprojne te pavarur nga njeri tjetri dhe kane kopetenca te plota, te pa kufizuara, ne zbatim te statutit dhe ligjit per shoqerite tregtare.

## NENI 7

Organizimi i shoqerise ,marredheniet me persona fizik e juridike ,vendas apo te huaj ,shprehen ne status qe bashke me aktin themelimit jane dokumentat baze te veprimtarise dhe sherbejne per zhvillimin e marredhenieve ne kete shoqeri

## NENI 8

Veprimtarine e saj ,shoqeria do te zhvilloje ne perputhje me legjislacioni Shqiptar.

## NENI 9

Te gjitha mosmarreshjet me persona fizike ose juridik si dhe me organet shteterore zgjidhen me mirekuptim , me ane te dispozitave te ketij akti ,statuti si dhe legjislacioni shqiptar dhe kur keto mjete nuk japin rezultat atehere zgjidhen me gjykate

Ky akt themelimi hyn ne fuqi dite e rregjistrimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **3IS Holding** ne QKB ne kete dite shoqeria **3IS Holding** njihet si person juridik

## ORTAKET E SHOQERISE

Z. Islam Isufaj

Z. Evis Isufaj

Shoqeria" A I"  
(Perfaqesuar nga administratori)

Z. Arben Isufaj

